




SBASHK Arsimimi sot

Janar, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK takim me kryetarët e sindikatës së nivelit komunal dhe të universiteteve Bashkëbisedë për planin e punës për vitin 2024



Për të bashkëbiseduar për situatën aktuale në arsim dhe për të dhënë ide për planin e punës në vitin 2024 SBASHK-u ka mbajtur takimin e radhës me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të universiteteve. Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka folur për tryezën e mbajtur më 15 dhjetor të vitit të kaluar, që ishte takim përparimor për një Konferencë me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të ndërlidhura me arsimin.

Ai ka shtuar se pjesëmarrësit e tryezës kanë vlerësuar lart idenë e përbashkët të SBASHK-ut dhe Qendrës Amerikane të Solidaritetit për organizimin e Konferencës me temën kyçe “Kujdesi për shëndetin mendor në...(faqe 4)

Vazhdohet me përgatitjet për Konferencën e 20 e 21 shkurtit

Përfaqësuesit e SBASHK-ut vizituan Odën e Mjekëve të Kosovës



Përfaqësuesit e SBASHK-ut vazhdojnë ...(faqe 5)

Intervistë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Do të angazhohemi për të realizuar gjithë detyrat e parapara për këtë vit



Koordinatori për organizim të brendshëm ... (faqe 3)

Dy aktivitete të veçanta të SBASHK-ut në janar
Takime në Odën Ekonomike dhe në Odën e Infermierëve të Kosovës



Duke dëshmuar se SBASHK-u u ...(faqe 4)

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim u takua me përfaqësues të SBASHK-ut

Gatishmëri për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman ...(faqe 5)



Editorial



Janari sjell pushimin dimëror e pastaj nxënësit dhe mësime të reja të Kosovës rifillojnë betejën për njohuri të reja. Kjo betejë nuk do të jetë e lehtë sepse mësuesit bashkë me nxënësit do të vazhdojnë betejën për dije të reja pa kushte të punës që kërkon shekulli XXI.

Ky vit do të jetë sfidues edhe për SBASHK-un dhe prandaj në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit e me ekspert ndërkombëtar do të punojmë Planin Strategjik të aktiviteteve me qëllim të mobilizimit për fusha konkrete të angazhimit. Po ashtu do të vazhdojmë me aktivitetet sindikale duke bashkëbiseduar me veprimtarë sindikalë e me

anëtarësinë për të marrë ide të reja të angazhimit. SBASHK-u do të vazhdojë bashkëpunimin me Qendrën Amerikane të Solidaritetit duke zhvilluar veprimtari që forcojnë zërin sindikal, por edhe të tilla që janë në shërbim të arsimit dhe shkollës. Një aktivitet i tillë do të jetë edhe Konferenca e 20 e 21 shkurtit që do të bëjë bashkë palët e ndërlidhura me arsimin dhe ekspertë që ndërlidhën me ruajtjen e shëndetit mendor në shkollë.

SBASHK-u do të vazhdojë edhe me aktivitete të tjera duke bashkëpunuar me Qendrën Amerikane të Solidaritetit dhe do të jap kontribut në të gjitha angazhimet e palëve tjera në shërbim të arsimit në Kosovë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org


Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Do të angazhohemi për të realizuar gjithë detyrat e parapara për këtë vit



Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror vazhdojnë angazhimet për të realizuar detyrat konkrete, që janë planifikuar për pjesën e parë të vitit 2024. Në këtë intervistë për gazetën tonë Ymeri do të na tregojë lidhur me aktivitetet kryesore, që janë duke u zhvilluar dhe për disa nga detyrat në të ardhmen.

Arsimimi sot:

Cilat janë aktivitetet që po zhvillonin në fillim të këtij viti ?

Ymeri

Janë shumë aktivitete, por do të veçoja angazhimin maksimal bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit për organizimin sa më të mirë të Konferencës “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”. Në tryezën e 15 dhjetorit të vitit të kaluar kanë marrë pjesë të gjitha palët që janë të ndërlidhura me arsimin dhe kanë vlerësuar lart këtë ide. Besojmë shumë se ekspertët e fushës dhe mysafirët nga shtete të tjera do të japin kontribut me vlerë dhe Konferenca do të ketë rrjedhë të mbarë.

Arsimimi sot

Cili është një aktivitet tjetër me të cilin ju dhe stafi jeni të angazhuar tani?

Ymeri

Në koordinim edhe me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve jemi duke bërë përgatitje edhe për shënimin e ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe. Jemi duke mbledhur shënime për gjithë koleget dhe kolegët që janë pensionuar nga fundi i marsit të vitit të kluar e deri në marsin e këtij viti dhe do t'u ndajmë mirënjohje në ceremonitë festive që do të organizohen në komuna dhe universitete. Është ky një moment kur pishtarëve të dijes do t'u shprehet respekti për punën dhe angazhimin nëpër vite e dekada në arsimin dhe edukimin e brezave.

Arsimimi sot

Krahas angazhimeve të përditshme, cili aktivitet kërkon po ashtu përkushtim shtesë ?


Ymeri

Është një aktivitet që tani më është bërë tradicional. SBASHK-u në shenjë respekti për angazhimet dhe për t'ju mundësuar që së paku disa ditë të pushojnë në bregdetin shqiptar organizon pushime për një numër të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve të SBASHK-ut nga e tërë Kosova. Ky aktivitet në dukje duket i lehtë, por kërkon angazhim të shtuar sepse duam që pushuesit të kalojnë mirë dhe këtë e kemi arritur deri tani për çka dëshmojnë edhe përshtypjet që ata i kanë lënë të shkruara.

Gjatë muajit


SBASHK takim me kryetarët e sindikatës së nivelit komunal dhe të universiteteve **Bashkëbisedë për planin e punës për vitin 2024**

Për të bashkëbiseduar për situatën aktuale në arsim dhe për të dhënë ide për planin e punës në vitin 2024 SBASHK-u ka mbajtur takimin e radhës me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të universiteteve. Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka folur për tryezën e mbajtur më 15 dhjetor të vitit të kaluar, që ishte takim përgatitor për një Konferencë me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të ndërlidhura me arsimin.



Ai ka shtuar se pjesëmarrësit e tryezës kanë vlerësuar lart idenë e përbashkët të SBASHK-ut dhe Qendrës Amerikane të Solidaritetit për organizimin e Konferencës me temën kyçe “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”, e cila do të mbahet në Prishtinë më 20 e 21 shkurt. Pas kësaj nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë zhvilluar një bashkëbisedë me pjesëmarrësit duke analizuar agjendën

fillestare e duke përcaktuar detyra konkrete për veprimtarët e SBASHK-ut me qëllim që kjo ngjarje e veçantë të ketë rrjedhë të mbarë. Pas kësaj u bisedua edhe për ndihmën që duhet ofruar profesorëve të Departamentit të gazetarisë për ta realizuar një anketë në disa shkolla të Kosovës lidhur me edukimin medial me shpresën se në të ardhmen e afërt edukimi medial mund të jetë një lëndë e re mësimore në



shkollat e Kosovës.

Në këtë takim me kryetarët e sindikatës së nivelit komunal dhe të universiteteve u bisedua edhe për nisjen e përgatitjeve fillestare për shënimin e ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe duke u ndarë edhe detyra konkrete për realizimin e këtij aktiviteti. Në vazhdim u debatua edhe për çështje të tjera që janë ngritur nga pjesëmarrësit e këtij takimi nga larg.

Dy aktivitete të veçanta të SBASHK-ut në janar **Takime në Odën Ekonomike dhe në Odën e Infermierëve të Kosovës**

Duke dëshmuar se SBASHK-u u gëzohet angazhimeve dhe arritjeve të të tjerëve e duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me ta, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me anëtarë të stafit qendror kanë vizituar Odën Ekonomike të Kosovës dhe Odën e Infermierëve të Kosovës.

Në selinë e Odës Ekonomike të Kosovës kryetari Jasharaj dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri janë pritur nga kryetari i OEK-së, Lulzim Rafuna dhe anëtarë të stafit të Odës. Ata biseduan rreth bashkëpunimit në projekte të përbashkëta si dhe zbatimin e mësimit dual në Republikën e Kosovës, pasi që OEK zyrtarisht ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit për zbatimin e mësimit dual në Kosovë. Të dy palët kanë vlerësuar se ky është një element me shumë rëndësi për vendin tonë në ndërlidhjen e aftësimit profesional me tregun e punës.



Krahas aktiviteteve të tjera e në kuadër të përgatitjes për Konferencën “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”, që SBASHK do ta organizojë më 20 e 21 shkurt bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit,

kryetari Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtaren Afërdita Mirena Ahmeti kanë vizituar selinë e Odës së Infermierëve të Kosovës. Kryetarja Nexhmije Gori bashkë me anëtarë të stafit të kësaj Ode janë shprehur të nderuar me këtë vizitë dhe kanë njoftuar mysafirët për angazhimet e përditshme që bëhen në shërbim të anëtarësisë. Kryetari Jasharaj ka përgëzuar mikpritësen për arritjet e shumta të Odës e pastaj ka treguar edhe për disa nga aktivitetet e SBASHK-ut duke u ndalur të përgatitjet

për Konferencën “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”. Nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë treguar për detajet dhe për agjendën fillestare të Konferencës duke kërkuar mbështetjen e OIK-së. Kryetarja e kësaj Ode Nexhmije Gori ka përgëzuar SBASHK-un dhe Qendrën Amerikane të Solidaritetit për këtë angazhim duke shprehur se tema kyçe në këtë aktivitet është shumë e qëlluar. Kryetarja Gori ka shprehur gatishmërinë që Oda të ndihmojë në rrjedhën e mbarë të Konferencës së 20 e 21 shkurtit.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim u takua me përfaqësues të SBASHK-ut **Gatishmëri për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit**



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe nënkryetarja Vjollca Shala janë takuar në ambientet e parlamentit të Kosovës me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim Ardian Gola. Jasharaj ka deklaruar se janë shumë çështje në arsim që duhen debatuar dhe prandaj ka kërkuar nga kryetari Gola që të organizohet një takim i anëtarëve të Komisionit parlamentar për Arsim me përfaqësuesit e SBASHK-ut për të debatuar për

të gjitha çështjet aktuale në arsim dhe për të bërë bashkërisht përpjekje në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim. Jasharaj i ka shprehur shqetësimet e SBASHK-ut edhe lidhur me ndryshimet që janë bërë në skemën pensionale e që kanë prekur në të drejtat e fituara të punëtorëve të pensionuar arsimor dhe ka lutur z. Gola që të gjej kohë për t'u takuar me përfaqësuesit e SBASHK-ut, që do të ofronin fakte e argumente për çështjen e ngritur.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, deputeti Ardian Gola ka shprehur gatishmërinë për të realizuar së shpejti takim me përfaqësuesit e SBASHK-ut lidhur me çështjen e ngritur për skemat pensionale dhe për një takim me Komisionin Parlamentar për Arsim.

Nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala ka informuar kryetarin Gola për gjithë angazhimet që janë bërë e do të bëhen në mënyrë që Konferenca e 20 dhe 21 shkurtit “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës” të jetë e organizuar mirë dhe të arrij objektivat e parapara. Kryetari Gola ka përgëzuar SBASHK-un dhe Qendrën Amerikane të Solidaritetit për idenë e qëlluar të mbajtjes së këtij aktiviteti duke uruar që panelistët dhe pjesëmarrësit të japin kontribut të lartë me qëllim që të nxjerrën edhe rekomandime për të gjitha palët se çfarë mund të bëhet në të ardhmen në shërbim të arsimit në Kosovë.

Vazhdohet me përgatitjet për Konferencën e 20 e 21 shkurtit **Përfaqësuesit e SBASHK-ut vizituan Odën e Mjekëve të Kosovës**


Përfaqësuesit e SBASHK-ut vazhdojnë me konsultimet me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të Konferencës “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”. Në kuadër të këtij angazhimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri kanë vizituar Odën e Mjekëve të Kosovës. Ata janë takuar me kryetarin e kësaj Ode dr. Pleurat Sejdiu.

Ky ishte takim i shkëmbimeve të mendimeve si dhe u diskutua për kontributin e mundshëm të OMK-së, në konferencën “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”, që SBASHK në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit do të mbaj më 20 e 21 shkurt.



SBASHK vazhdon përgatitjet për një ngjarje të veçantë arsimore Organizohet Konferenca “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”

Duke e vlerësuar si shumë të nevojshëm angazhimin e të gjitha palëve që bashkërisht të kontribuojnë dhe të nxjerrin përfundime e detyra konkrete, SBASHK-u në mbështetje të Qendrës Amerikane të Solidaritetit kishin bërë bashkë në një tryezë tematike më 15 dhjetor të vitit të kaluar përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale, të kështjllit të prindërve, të psikologëve, medieeve e të shoqërisë civile për të caktuar detyra konkrete për një Konferencë kombëtare me temën kyçe “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”. Shtimi i rrezikut nga prania e dukurive negative në shkolla dhe përplasjet e kacafytjet, që po përfundojnë me lëndime të rënda e madje edhe me vdekjen e të rinjve e shtojnë arsyen për një aktivitet të tillë. Pjesëmarrësit e kësaj tryeze kanë caktuar datat 20 dhe 21 shkurt për mbajtjen e Konferencës “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”.



SBASHK-u bashkë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit janë duke vazhduar me angazhimet me qëllim që në këtë ngjarje të veçantë të jenë pjesëmarrës specialistë të kësaj fushe dhe të nxjerrin detyra konkrete të angazhimeve për secilën palë që është e ndërlidhur me arsimin. Në kuadër të angazhimeve për përgatitjen e kësaj Konferencë përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë zhvilluar konsulta të vazhdueshme me përfaqësues të Qendrës Amerikane të Solidaritetit, por edhe me Odën e mjekëve dhe të infermierëve me qëllim që ata të kontribuojnë me profesionalistë të fushës për në rrjedhën e mbarë të kësaj Konferencë. Në Konferencë do të marrë pjesë edhe drejtorja ekzekutive e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington Shauna Bader Blau, përfaqësues të sindikatave simotra nga Sllovenia dhe vende të Ballkanit dhe profesionalistë të shumtë të fushës që ndërlidhet me temën e kësaj ngjarje të veçantë për arsimin në Kosovë. Për shkak të angazhimeve të shumta dhe pamundësisë që të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin në Kosovë, drejtorja e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Suzan Flocken do t’ju drejtohet pjesëmarrësve me një lidhje nga larg.

SBASHK vazhdon me aktivitete në shërbim të anëtarësisë U nënshkrua memorandum bashkëpunimi me “Optika Moda”



Kryetari i SBASHK - u t Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri vizituan ambientet e “Optika Moda”

SH.P.K në Fushë Kosovë. Ata fillimisht u takuan me pronarin Basri Asllani, i cili duke u dëshiruar mirëseardhje mysafirëve e në shenjë respekti për ta dhe për gjithë punëtorët e arsimit i ka njoftuar me ambientet e këtij institucioni. Përfaqësuesit e SBASHK-ut përgëzuan pronarin Asllani për gjithë angazhimet dhe arritjet dhe kanë parë nga afër aparaturën mjekësore, që është fjala e fundit e teknologjisë për këtë fushë të shëndetësisë. Pas kësaj ata në një ceremoni festive kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, objekt i të cilit është ofrimi i shërbimeve që kryhen në “Optika Moda” e që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj syrit. Anëtarët e SBASHK-ut këtu mund të kryejnë kontrollin mjekësor të syve me aparaturën më të sofistikuar, pastaj ekzaminimin e syrit, përcaktimin e dioptrisë dhe ofrimit të syzeve. Në memorandum saktësohet se kontrolli mjekësor për sy me

aparaturën më të sofistikuar, ekzaminimin e syrit dhe përcaktimi i dioptrisë ofrohen pa pagesë për gjithë anëtarët e SBASHK-ut dhe anëtarët e familjes së ngushtë. Memorandumi, po ashtu, saktëson se anëtarët e SBASHK-ut përfitojnë zbritje për syze dioptrike prej 50% nga çmimi ekzistues në ditën e marrjes, ndërsa për anëtarët e familjes së tyre zbritja është 30 %. Po ashtu anëtarët e SBASHK-ut përfitojnë nga ky memorandum mirëkuptimi zbritje prej 35% për syze të diellit si dhe në lente kontakti dhe xhama dioptrik, ndërsa për anëtarët e familjes së tyre të ngushtë kjo zbritje është 20%.



Duhet theksuar se ky memorandum mirëkuptimi vlen për “Optika Moda” kudo në Kosovë dhe atë: Prishtinë në Albi Mall, Rruga B, rruga “Agim Ramadani”, në Fushë Kosovë, në Lipjan, Ferizaj, Vushtri, Mitrovicë, Suharekë, Gjilan, Prizren, Klinë e Pejë e së shpejti edhe në Podujevë e Gjakovë.

Forcohet bashkëpunimi me Qendrën Amerikane të Solidaritetit Takim përmbajtjesor në Prizren

Qendra Amerikane e Solidaritetit duke parë angazhimin e përkushtuar dhe seriozitetin e SBASHK-ut po angazhohet të forcojë bashkëpunimin me sindikatën tonë. Kështu, përveç angazhimeve të përbashkëta që Konferenca e 20 dhe 21 shkurtit “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës” të ketë rrjedhë të mbarë dhe të nxjerr konkluzione e detyra konkrete për të gjitha palët që ndërlidhën me arsimin, kjo Qendër ka organizuar një takim pune në Prizren. Në këtë takim ishin drejtori i Qendrës Steven McCloud, zyrtarja Kejsi Gaxha, mysafirët nga SHBA, drejtori i organizimit Andrew Tillet Saks dhe zyrtari për programe e organizim i Qendrës në nivel qendror Simon Rosenblum-Larson, kurse SBASHK-u është përfaqësuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Kontribut në këtë takim pune kanë dhënë edhe kryetari i BSPK-së Atdhe Hykolli dhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prizrenin, Reshit Kushaj.

Drejtori i Qendrës Steven McCloud në hapje të takimit ka prezantuar pjesëmarrësit e pastaj ka lavdëruar angazhimet dhe përkushtimet e SBASHK-ut duke treguar edhe aktivitetet e

përbashkëta që kanë pasur rrjedhë të mbarë dhe kanë dhënë rezultate konkrete e duke uruar që Konferenca e 20 dhe 21 shkurtit “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës” të ketë rrjedhë të mbarë dhe të nxjerr konkluzione e detyra konkrete për të gjitha palët që ndërlidhën me arsimin. Kryetari Jasharaj ka treguar për angazhimet dhe sfidat e SBASHK-ut për t’u ndalur te disa nga momentet me të veçanta. Ai duke treguar për bashkëpunimin dhe miqësinë nëpër vite e dekada të SBASHK-ut me Sindikatën e mësuesve të Amerikës është shprehur se pret që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe të forcohet.

Andrew Tillet-Saks dhe Simon Rosenblum-Larson janë shprehur të kënaqur me bashkëpunimin e SBASHK-ut me Qendrën Amerikane të Solidaritetit duke theksuar se edhe ata janë të gatshëm të japin kontribut bashkë me veprimtarë të tjerë në aktivitetet sindikale. Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri ka falënderuar drejtorin Steven dhe stafin e zyrës në Tiranë të Qendrës Amerikane të Solidaritetit duke treguar për aktivitete të përbashkëta e duke theksuar edhe arritjet konkrete.

